

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Plehra kimike,furnitura veterinare,farëra,fidanë e të tjera produkte agrokulturore (e ndarë me lote)”**

**Loti 1 : Blerje farë bari**

**Loti 2 : Blerje lule sezonale**

**Loti 3 : Pesticide**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Fara Lulesh 03111900-1, Plehra të ndryshme 24440000-0.**

**VLERA E FONDIT LIMIT Total: 3 328 350** (tre milion e treqind e njëzet e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë) **Lekë pa Tvsh,**

**Loti 1 : Blerje farë bari,** fondi limit është: **830 000** (tetëqind e tridhjetë mijë) **Lekë pa Tvsh**

**Loti 2 : Blerje lule sezonale,** fondi limit është: **2 083 250** (dy milion e tetëdhjetë tre mijë e dyqind e pesëdhjetë) **Lekë pa Tvsh**

**Loti 3 : Pesticide,** fondi limit është: **415 100** (katër qind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind) **Lekë pa Tvsh Monedha, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

## **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Plotësohet me plotësimin e kriterëve të përgjithshme

## **1.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

### **Loti 1 “Blerje farë bari”**

#### **1.1 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

Për të provuar kapacitetin financiar dhe ekonomik, Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

#### **1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2020, 2021, 2022 të vërtetuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.**

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

#### **2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore lëshuar nga Administrata Tatimore të viteve 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera të mos jetë më e vogël se vlera e fondit limit të lotit përkatës.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

**3.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore** të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2023 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisive të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e TaksaveVendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar.

Enti /Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e informacionit te paraqitur ne procedure e prokurimit.Ne rast informacioni te pasakte do te veprohet konform parashikimeve te ligjit Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **1.2 Për kapacitetin teknik:**

1. Furnizime të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se **40 %** e fondit limit të lotit përkatës .

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
  - o kontratën e lidhur si dhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e furnizimeve dhe/ose

- faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke qenë se vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar, vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Per kete arsye eshte kerkuar një ose disa furnizime të ngjashme në vlerën sa 40% e vlerës se kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2. Operatori Ekonomik të ketë të paktën 1 (një) agronom të lartë, të vertetuar me diplomë, kontratë pune dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për periudhë 3 muajt e fundit nga data e shpalljes se procedurës së prokurimit, lëshuar nga administrata tatimore.
3. Liçencë, Kodi II.4, për “Prodhim dhe/ose tregtimi i farave dhe/ose fidanëve”, lëshuar nga QKL
4. Liçencë, kodi II.5.A për “tregtimin me pakicë të produkteve të mbrojtjes së bimëve” lëshuar nga QKL.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, licenca e mësipërme që kërkohet është e lëshuar nga QKL dhe licenca është e lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit, e përfshirë në fushën e gjelbërimit dhe kërkimi i saj që të zotërohet nga OE pjesëmarrës në procedurë tregon kualifikim dhe cilësi.

5. Të ketë në pronësi ose me qera mjetet për transportin e mallit objekt prokurimi si më poshtë:
  - Kamioncin, copë 1, me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, në pronësi ose me qira.

Të paisura me dokumentet si më poshtë:

- Çerifikatë pronësie ose kontrate qeraje e lidhur tek noteri, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- Leje qarkullimi
- Çertifikaten e kontrollit teknik
- Siguracionin e mjetit

Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (shitblerje ose kontrata dhurimi).

Mjetet me qira shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi).

Për mjetet që shënohen në rregjistrat publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton rregjistrimin si leje qarkullimi, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme ) me foto.

Për mjetet me qira duhet të paraqitet dokumenti që vërteton rregjistrimin e tij plus çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (e vlefshme) dhe foto. Duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i mjeteve në pronësi / qira / kontratë furnizimi është minimal në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtësisht me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate do të transportohet nga furnizuesi në ambientin ku do të magazinohet nga autoriteti kontraktor. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

6. Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese që makineritë e paraqitura në këtë procedurë nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, si dhe do të jenë në dispozicion të këtij objekti, deri në përfundimin dhe realizimin e kushteve të kontratës.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme dhe të disponueshme për realizimin me sukses të kontratës.

7. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur. Në rast deklarimi të rremë, do të veprohet konform parashikimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”. Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë i japin siguri dhe garanci AK mbi vërtetësinë e informacionit të dhënë për realizimin me sukses të kontratës.

8. Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë në tender një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ku të deklarojë se është dakort që autoriteti kontraktor të kryejë verifikim paraprak pranë kantierit të deklaruar për vendndodhjen e mjeteve.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri AK fiton të drejtën për verifikimin në terren të mjeteve të kërkuara për realizimin me sukses të kontratës.

9. Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë në tender një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ku autorizon autoritetin kontraktor të verifikojë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, duke ruajtur kushtet e konfidencialitetit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri AK fiton të drejtën për verifikimin e gjithë dokumentacionit të kërkuara për realizimin me sukses të kontratës.

Në të gjitha rastet kur është përmendur emri ose markë, njihet barazvleshmëria ose ekuivalent.

Mos paraqitja e deklaratave në formën dhe mënyrën e kërkuar, përbën shkak për skualifikim.

Dhënia e informacionit të rremë, përbën shkak për skualifikim, si dhe do të veprohet konform parashikimeve të nenit 13 të LPP.

I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur në tender, duhet të jetë në gjuhën e ofertës, në rast të kundërt përbën shkak për skualifikim

## Loti 2 “Blerje lule sezonale”

### 2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit përkatës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2020, 2021, 2022 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

**3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore** të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2023 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisve të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e TaksaveVendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar.

Enti /Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e informacionit te paraqitur ne procedure e prokurimit.Ne rast informacioni te pasakte do te vepohet konform parashikimeve te ligjit Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”.

### **Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8)

**Argumentimi:** Kërkesa e mëposhtme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 40, pika 5, 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2 Kapaciteti teknik:**

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40 % e fondit limit të lotit përkatës objekt prokurimi (pa TVSH).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:



Kur Operatori Ekonomik ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke qenë se vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar, vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Per kete arsye eshte kerkuar një ose disa furnizime të ngjashme në vlerën sa 40% e vlerës se kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

## **2.2.2 Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik:**

Një punësim mesatar i të paktën 5 (pesë) punonjës (duke përfshire stafin tekniko – menaxherial), për periudhën e 3 ( tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së procedurës së prokurimit, e dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga Administrata Tatimore, si dhe listëpagesa e çdo muaji të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi (Formulari numër E-SIG 025/a.1) për periudhën e 3 ( tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së procedurës së prokurimit.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si natyra e mallit objekt kontrate që kërkohet të furnizohet (kemi marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate ka nevojë ditore për mirëmbajtje dhe shërbime), grafiku i lëvrimit dhe kualifikimi i punonjësve (element shumë i rëndësishëm lidhur me njohuritë e tyre specifike në mirëmbajtjen e luleve sezonale), dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve, kualifikimi i tyre, grafiku i lëvrimit dhe natyra e mallit

objekt prokurimi, me kohështrirje Nentor 2021– Janar 2022, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë me sukses kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 10 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik menaxherial, është në përputhje me volumin e punës, natyrën ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

a) Operatorët ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar për periudhën e tre muajve të fundit nga data e shpalljes së procedurës së prokurimit:

- 1 (një) Agronom të shoqëruar me diplomë, kontrate pune.
- 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për "punime në fidanishte" që vërtetohen me çertifikata profesionale, lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj të shoqëruar me kontrate pune.

Bashkëlidhur listëpagesa e cdo muaji të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi (Formulari numër E-SIG 025/a.1) për periudhën e 3 muajve të fundit nga data e shpalljes së procedurës së prokurimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, dhe natyrën e mallit që kërkohet të furnizohet. Nevoja për agronom dhe të paktën 3 punonjës të kualifikuar për punime në fidanishte, është e lidhur ngushtësisht me natyrën dhe artikujt objekt kontrate. Mungesa e këtij stafi potencialisht mund të çojë në dështimin e kontratës së furnizimit, ose në rastin më pak të keq do

të rezultojë në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe furnizimin e mallit me cilësi të dobët. Numri i stafit kryesor teknik është minimal dhe është përcaktuar në raport të ngushtë me natyrën specifike të mallit objekt kontrate.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**2.3.4 Operatori ekonomik** duhet të provojë se disponon ambient mbështetës të specializuar për të magazinuar bimët (fidanishte) me sipërfaqe mbi 4.000 (mijë), me kushte optimale të furnizimit me ujë dhe plehërimin për të vërtetuar këtë operator ekonomik duhet paraqes dokumentacionin që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen:

a) *Dokumentacioni që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen:*

*Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

*Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

- *Kontratë huapërdorje.*

*Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- *Kontratë qiraje.*

b) *Foto të ambientit të magazinimit të bimët (fidanishte).*

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të mirëmbaje në fidanishte bimët me kushte optimale të furnizimit me ujë, plehërimin për bimët deri në momentin e dorëzimit tek autoriteti kontraktor sipas specifikimeve teknike të kërkuara. (Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument).

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Në nennin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, parshiukohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Në rastin konkret, duke qenë se objekti dhe natyra e kontratës lidhet me furnizimin e bimesis, është e nevojshme për autoritetin kontraktor që të provohet se operatori ekonomik disponon kushtet për mirëmbajtjen e mallit objekt kontrate. Po kështu element shumë i rëndësishëm është edhe grafiku i lëvrimit të mallit ku përcaktohet se malli do të furnizohet në mënyrë periodike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, fakt i cili e bën të domosdoshëm pasjen e një ambienti mbështetës të specializuar për të magazinuar bimët (fidanishte).

### **2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatat si më poshtë:**

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatat ISO 9001 – 2015 për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo çertifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

### **2.3.6 Disponimi i mjeteve të mëposhtme:**

1. Të ketë në pronësi ose me qera mjetet për transportin e mallit objekt prokurimi si më poshtë:

- Kamioncin, copë 2 (dy), me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, në pronësi ose me qira.

Të paisura me dokumentet si më poshtë:

- Çertifikatë pronësie ose kontrate qeraje e lidhur tek noteri, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- Leje qarkullimi
- Çertifikaten e kontrollit teknik
- Siguracionin e mjetit

Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (shitblerje ose kontrata dhurimi).

Mjetet me qira shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi).

Për mjetet që shënohen në rregjistrat publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton rregjistrimin si leje qarkullimi, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme ) me foto.

Për mjetet me qira duhet të paraqitet dokumenti që vërteton rregjistrimin e tij plus çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (e vlefshme) dhe foto. Duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Numri dhe lloji i mjeteve në pronësi / qira / kontratë furnizimi është minimal në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtësisht me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate do të transportohet nga furnizuesi në ambinetin ku do të magazinohet nga autoriteti kontraktor. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i mjeteve në pronësi / qira / kontrate furnizimi është minimal në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtësisht me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate do të transportohet nga furnizuesi në ambinetin ku do të mbillet/vendoset sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Dokumentet e lëshuara nga autoritetet publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961.

Në rast të një sipërmarrjeje të përbashkët operatorësh ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë dokumentet e sipër përmendura.

Në rast të një bashkimi shoqerish (operatorë të përbashkët) duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtëme:

\* Marrëveshje e noterizuar sipas së cilës është krijuar zyrtarisht sipërmarrja e përbashkët e operatorëve ekonomikë.

\* Prokurën e vecantë.

\* Vendimin e palëve vendimmarrëse të shoqerisë ose Sipërmarrjes së Përbashkët të Shoqerive dhe/ose Bashkimit të Shoqerive.

Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqip ose anglisht si dhe në rastin e dokumenteve të lëshuara nga autoritete publike, t'i certifikojnë ato me vulën "Apostille". Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e këtyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Per vetedeklaratat e paraqitura nga nga ofertuesit e huaj duhet te kryhet vertetimi i firmes para nje noteri dhe certifikimi me vulen apostile. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s'kualifikues

### **Loti 3 "Pesticide"**

#### **2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

Për të provuar kapacitetin financiar dhe ekonomik, Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

1. Kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2020, 2021, 2022 të vërtetuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

**Argumentimi:**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

3 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore lëshuar nga Administrata Tatimore të viteve 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera të mos jetë më e vogël se vlera e fondit limit të lotit përkatës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

**3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore** të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2023 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisive të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e TaksaveVendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar.

Enti /Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e informacionit te paraqitur ne procedure e prokurimit.Ne rast informacioni te pasakte do te veprohet konform parashikimeve te ligjit Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”.

### **1.3 Për kapacitetin teknik:**

1. ISO 9001:2015 “Sistem menaxherial të cilësisë” për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme), e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurrohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo çertifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2. Operatori Ekonomik të ketë të paktën 1(një) agronom të lartë, të vertetur me diplomë, kontratë pune dhe rezultojë në listpagesat e shoqërisë për periudhë e 3 ( tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së procedurës së prokurimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për një Agronom lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, dhe natyrën e mallit që kërkohet të furnizohet. Mungesa e Agronomit potencialisht mund të çojë në dështimin e kontratës së furnizimit, ose në rastin më pak të keq do të rezultojë në realizim jashtë normave dhe furnizimin e mallit me cilësi të dobët. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.



Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e Agronomit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

### **3. Të ketë në pronësi ose me qera mjetet për transportin e mallit objekt prokurimi si më poshtë:**

- Kamioncin, copë 1, me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, në pronësi ose me qira.

Të paisura me dokumentet si më poshtë:

- Çerifikatë pronësie ose kontrate qeraje e lidhur tek noteri, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- Leje qarkullimi
- Çertifikaten e kontrollit teknik
- Siguracionin e mjetit

Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (shitblerje ose kontrata dhurimi).

Mjetet me qira shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi).

Për mjetet që shënohen në rregjistrat publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton rregjistrimin si leje qarkullimi, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme ) me foto.

Për mjetet me qira duhet të paraqitet dokumenti që vërteton rregjistrimin e tij plus çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (e vlefshme) dhe foto. Duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i mjeteve në pronësi / qira / kontratë furnizimi është minimal në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtësisht me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate do të transportohet nga furnizuesi në ambinetin ku do të magazinohet nga autoriteti kontraktor. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë

autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

- 4 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur. Në rast deklarimi të rremë, do të veprohet konform parashikimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Per Prokurimin Publik”. Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë i japin siguri dhe garanci AK mbi vërtetësinë e informacionit të dhënë për realizimin me sukses të kontratës.

- 5 Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë në tender një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ku autorizon autoritetin kontraktor të verifikojë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, duke ruajtur kushtet e konfidencialitetit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri AK fiton të drejtën për verifikimin e gjithë dokumentacionit të kërkuara për realizimin me sukses të kontratës.

- 6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në tender një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë që i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur në tender është i saktë dhe nuk permban të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri operatori ekonomik garanton AK mbi vërtetësinë e informacionit të paraqitur për realizimin me sukses të kontratës.

Në të gjitha rastet kur është përmendur emri ose markë, njihet barazavleshmëria ose ekuivalent.

Mos paraqitja e deklaratave në formën dhe mënyrën e kërkuar, përbën shkak për skualifikim.

Dhënia e informacionit të rremë, përbën shkak për skualifikim, si dhe do të veprohet konform parashikimeve të nenit 13 të LPP.

I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur në tender, duhet të jetë në gjuhën e ofertës, në rast të kundërt përbën shkak për skualifikim.

- 7 Operatori ekonomik fitues mer përsipër transportimin e pesticideve deri në pikën e magazinimit të Autoritetit Kontraktor.

**Shenim;** Në të 3 lotet në kriteret ku janë kërkuar mjetet dhe numri i punonjësve operatorët ekonomik fitues duhet që: *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>1</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>2</sup>. **Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin***

**Argumentimi:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi Ç) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

---

